



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivered	27 - 11 2020	viti god year	0
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHKK	2791/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.Nr.314/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi- Bajraktari, kryetarë Eshref Shabani, dhe Jeton Kocaanëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesës me numër A. Nr.314/2020, të datës 22.10.2020 të parashtruar nga ankuesit ██████████, me adrese fshati Sillovi „Lagje e re”, Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “ vlerësimi i punës’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 25/11/2020, mori këtë.

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A. Nr. 314/2020, e datës 22.10.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████

A r s y e t i m

Ankuesi ██████████, i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës pozitën „Drejtor “ në Drejtoratin për Trajtim të Burgosure vë dhe të Miturëve në SHKK, me datën 15.01.2020, nga Njësia e Personelit e ka pranuar formularin për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2019, të nënshkruar nga Drejtor i Përgjithshme i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datën 23.12.2019.

Ankuesi ██████████ i pakënaqur me vlerësimin e vlerësuesit me date 15.01.2020 ka dhënë komentet në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë, ndërsa me datë 16.01.2020, ka bërë kërkesë-ankesë për rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2019 tek Ministri i Ministrisë së Drejtësisë.

Me datën 16.01.2020, ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019, ka parashtruar ankesën me numër 02\KA në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 10.02.2020, ka nxjerr vendim me numër 02\KA 2 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar duke e kthyer procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë.

Ankuesi [REDAKTUAR], i pakënaqur vendim me numër 02\KA 2, te datës 10.02.2020 t Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 22.10.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2182/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.10.2020, me numër protokoli 2239/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datën 12.11.2020 me numër protokoli 2560/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A Nr.314/2020 e datës 22.10.2020, me numër protokoli 2182/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E- maili i datës 18.02.2020; Vendimi i datës 10.02.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 16.01.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E- maili i datës 11.12.2019; E- mali 13.01.2020; Formulari i Vlerësimi të rezultateve në punë; ; E- maili i datës 10.02.2020 për dorëzimin e Vendimit te KZAK-së; E- maili i datës 14.02.2020 drejtuar kryesuesit te KZAK; Përgjigje në ankesë e datës 12.11.2020, me numër protokoli 2560/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar, se ankuesi [REDAKTUAR] nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 10.02.2020 kur ankuesi e ka pranuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ne baze te dëshmive te ofruara ka konstatuar se ankuesi [REDAKTUAR], Vendimin me numër 02\KA 2 të datës 10.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka pranuar përmes e- mailit zyrtar me datën 10.02.2020, ndërsa ankesën me numër protokoli 2182/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 22.10.2020, e qe është *jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh* të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafin 1. të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*", si dhe ne kundërshtim me nenin 11 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: *"Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.314/2020*


Rushit Kajtazi

Procesmbajtës


Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit ██████████
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së